REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
III- Nr. I prot / Br. prot. 2104 Më / Dt. 05.07.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal Rahovec

# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

## RAPORT GJASHTË MUJOR I PUNËS

## JANAR-QERSHOR 2024

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-qershor 2024, Drejtoria për Mbrotje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2024. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin sukseshëm punën gjashtë mujore të DMSH dhe NJPZSH.

- Gjatë periudhës Janar-Qershor, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë specifikisht në pikat kyqe ku situate shihet më e rënduar bëhet disa herë në vit në mënyrë që të eliminohet rreziku për vërshime.
Pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku a pasur nevojë për ndërhyrje.

- Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
Është kryer servisimi i parë për vitin 2024 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.

- Inspektori për parandalim ka pasur 7 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 11 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.
- Në këtë gjashtë mujor, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:
  -Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt Korrik dhe Gusht,në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejet I madh si pasojë e temperaturave të larta.
  -Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt Korrik dhe Gusht për vitin 2024, me të dhënat e dala nga ky dokument synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojte të pronës dhe jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.

- Ekipi i zjarrëfikësve gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, ka marrë gjithsej pesëdhjetë e gjashtë kërkesa për intervenime.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2020

| 2024 | Nr.i përgj. i daljeve | Nr.i zjarreve | Nr. i Teknike | Nr.i shërbimeve | Aksidente rrugore | Vërshime | Të rejsh | Të lënduar zj. | Të lënduar qyt. | Të lënduar tot | Të vdekur zj. | Të vdekur qyt. | Të vdekur tot | Gjithsejt |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 5 | 0 | 1 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| Shkurt | 29 | 24 | 2 | 0 | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29 |
| Mars | 13 | 11 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13 |
| Prill | 7 | 3 | 0 | 1 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| Maj | 11 | 3 | 3 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 0 | | 0 | 11 |
| Qershor | 18 | 10 | 2 | 5 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18 |

Më 4 Maj 2024, me një aktivitet simbolik shënuam Ditën Ndërkombëtare të Zjarrfikësve.











Drejtore e Drejtorisë për
Mbrojtje dhe Shpëtim
Besmire Bytyçi

Rahovec
05/06/2024